



**INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2004

Për caktimin e kushteve për licencimin e importuesve, për tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në:

Rregullorën e UNMIK-ut nr.2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 5.1 pika (n), Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d) dhe Ligjit për Plehrat Artificiale Nr. 2003/22 të dt. 23 qershor, neni 17.1 lidhur me nenin 4,

Nxjerr sa vijon:

Neni 1.

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet për licencimin e importuesve të plehrave artificiale, për tregtimin me to dhe për deponimin e tyre.

Neni 2.

Përsonat të cilët merren me importimin dhe tregtimin e plehrave artificiale duhet të licencohen nga Departamenti për Prodhimtari dhe Mbrojtje të Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Personi për t'u licencuar si importues, tregtues dhe deponues i plehrave artificiale, përveç regjistrimit të biznesit duhet t'i plotësojë edhe këto kushte të veçanta:

- të posedojë më së paku pregaditjen e mesme profesionale – nga lëmia e bujqësisë, ose të ketë të punësuar personini me kualifikim përkatës,
- të dëshmojë se posedon me objekte përkatëse për deponimin, ruajtjen dhe shitjen e plehrave artificiale.

Neni 3.

Për t'u licencuar si importues, tregtues të plehrave artificiale, personi duhet të aplikoj në MBPZHR.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të kërkesës për çertifikim, do t'i lëshojë licencë aplikuesit vetëm pasi të jetë e sigurtë se janë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Plehrat Artificiale dhe kushtet e përcaktuara me këte Udhëzim Administrativ.

Neni 4.

Plehrat artificiale mund të deponohen dhe të tregtohen vetëm në objektet të cilat përveç kushteve teknike të ndërtimit i plotësojnë edhe këto kuhte të veçanta:

- të jenë të mbuluara;
- të mos kenë lagështi dhe të mos i nënshtrohen kushteve atmosferike (të mos iu ekspozohen diellit, shiut dhe të reshurave të tjera) dhe si të tilla nuk lejohen të shiten;
- të jenë të ndara fizikisht, nga produktet ushqimore dhe
- paketimet të mos jenë të dëmtuara.

Neni 5.

Renditja e paketimeve (thaseve) duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos e tejkalojnë numrin e thasëve të renditur njëri mbi tjetrin më tepër se 12 thasë.

Rendi i parë i paketimeve (thasëve) të renditur, duhet të jetë i ngritur nga toka në lartësinë prej së paku 15 cm.

Neni 6.

Personat që merrën me importimin, tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale nuk mund t'a bëjnë ripaketimin dhe etiketimin e plehrave artificiale pa autorizimin e MBPZHR.

Neni 7.

Personi që merret me importimin, tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale nuk mund t'a keqpërdorë markën origjinale.

Neni 8.

Personat që merrën me importimin, tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale, duhet në çdo kohë të posedojnë edhe dokumentacionin vijues:

- Çertifikatën mbi regjistrimin e biznesit,
- Licencën e lëshuar nga MBPZHR,
- Faturën për blerjen e plehrave artificiale,
- Dokumentin mbi origjinën e plehrave artificiale dhe
- Librin mbi evidencën e posaçme të sasive të kontraktuara të plehrave artificiale.

Neni 9.

Personi që merret me importimin, tregtimin dhe deponimin e plehrave artificiale është i obliguar që në çdo kohë dhe në çdo vend (në depo apo në mjetin transportues) t'ia tregojë inspektorit të autorizuar dokumentacionin e kërkuar dhe ti mundësojë të njëjtit qasje të lirshme në çdo sasi të plehrave artificiale, përfshirë këtu edhe dhënjën e një sasive për analizim të mostrave në rast dyshimi.

Neni 10.

Për të gjitha çështjet tjera lidhur me punën dhe autorizimet e inspektorit, përfshirë këtu edhe ndalimin e importimit, tregtimit, deponimit apo konfiskimit të plehrave artificiale, aplikohen drejtëpërsedrejti dispozitat e Ligjit për Plehrat Artificiale që e rregullojnë punën e Inspektionit dhe dispozitat e ligjit të aplikueshëm për Punën e Inspektionit të Bujqësisë.

Neni 11.

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 15 të Ligjit për Plehrat Artificiale.

Neni 12.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më _____ 2004

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë,
Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural

/Goran Bogdanoviq/